



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:217161

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06794471

2024:217162

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL me gjyqtarin Driton Ahmeti dhe praktikanten Hedië Aliu, në çështjen juridike të paditësit J.G nga Ferizaj Rr.”...” të cilën me autorizim e përfaqëson av. Skender Jetishi nga Ferizaj, kundër të paditurit K.F nga Fsh..... K. Prizren, në çështjen juridike për pagesën e borxhit, jashtë seance me datë 03.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

Padi e paditësit J.G nga Ferizaj, kundër të paditurit K.F nga Fsh....., në çështjen juridike për pagesën e borxhit **KONSTATOHET SI E TËRHEQUR.**

A r s y e t i m i

Paditësi J.G përmes të autorizuarit të tij me datë 05.08.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurit K.F nga Fsh..... K. Prizren, në çështjen juridike kompensim dëmi.

Përfaqësuesi i paditësit me datë 31.01.2025, ka dorëzuar parashtrësë për tërheqje të padisë me të cilën e njofton Gjykatën se tërhiqen nga padia lidhur me pagesën e borxhit, për shkak se palët kane lidhur ujdi jashtë gjyqësore për pagesën e borxhit.

Gjykata vendimin e saj e ka marrë duke u bazuar në nenin 261 par.3 të LPK-së ku thuhet se “po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2024:217162, me datë 03.02.2024

G j y q t a r i:

Driton Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuare ankesa bazuar ne nenin 261 par.4 të LPK-së.